



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2740/Prot.

Tiranë, më 01.09.2025

VENDIM

Nr. 270, Datë 01.09.2025

**“PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË BYROSË KOMBËTARE
TË HETIMIT”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen plenare të datës 01.09.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2240, datë 19.08.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, pasi dëgjoi relatorin, z. Zeqir Hoda si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Pranë Këshilli të Lartë të Prokurorisë (*në vijim Këshilli*) është administruar me nr. 210/23 prot., datë 31.07.2025, Shkresa e drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit nr. 1212 prot., datë 31.07.2025, me lëndë “*Mbi lirimin nga detyra të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit*”.
2. Nëpërmjet kësaj shkrese, nga znj. Aida Veizaj (Hajnaj) është kërkuar vijimi i procedurave për shprehjen mbi përfundimin e mandatit dhe lirimin nga detyra e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (*në vijim BKH*).
3. Znj. Aida Veizaj (Hajnaj) është emëruar në pozicionin e drejtorit të BKH-së me Vendimin nr. 183, datë 30.07.2020, të Këshillit, për një mandat 5 (pesë) vjeçar, duke filluar nga data 01 shtator 2020.
4. Neni 35, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, parashikon se:

“1. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit lirohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:

- a) i përfundon mandati;*
- b) jep dorëheqjen;*
- c) mbush moshën e pensionit”.*

5. Nisur nga sa më sipër, në cilësinë e organit të emërtesës, Këshilli duhet të disponojë me vendim mbi lirimin nga detyra të drejtorit aktual të BKH-së, në përfundim të mandatit ligjor të tij.
6. Sipas vendimit të mësipërm të Këshillit, znj. Aida Veizaj (Hajnaj) e ushtron funksionin e Drejtorit të BKH-së nga data 01 shtator 2020 deri më datë 31 gusht 2025, duke qenë kjo data e fundit e qëndrimit në detyrë dhe e ushtrimit të funksionit.
7. Në këto kushte, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i propozoi Këshillit, miratimin e vendimit të lirimit të znj. Aida Veizaj (Hajna) nga detyra e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit për shkak të plotësimit të mandatit ligjor me kalimin e datës 31 gusht 2025.
8. Gjatë mbledhjes plenare, z. Mërkuri propozoi që, data e përfundimit të mandatit të znj. Veizaj (Hajnaj) të jetë data 01.09.2025, në referencë të nenit 56, pika 3, i Kodit të Procedurave Administrative.

PËR KËTO ARSYE:

SEKRETA

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenet 164, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 35, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Lirimin nga detyra të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, znj. Aida Veizaj (Hajnaj), për shkak të përfundimit të mandatit ligjor në datë 31.08.2025.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe znj. Aida Veizaj (Hajnaj);
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 01.09.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Sokol Stojani
(kundër)

ANËTAR
Zeqir Hoda

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji
(kundër)

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj
(kundër)

ANËTAR
Erind Merkuri
(kundër)

ANËTAR
Erion Fejzulla

MENDIM PAKICE

1. Ne anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Erind Gërmenji, Sokol Stojani, Olger Eminaj dhe Erind Merkuri, duke qenë se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, në lidhje me momentin e përfundimit të mandatit të drejtueses së Byrosë Kombëtare të Hetimit, e shohim të nevojshme që të dalim me qëndrim pakice, për të shpjeguar arsyet pse nuk e konsiderojmë të drejtë, vendimmarrjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Nga rrethanat e paraqitura, rezulton se znj. Aida Veizaj (Hajnaj) e ka filluar mandatin e saj në datën 01.09.2020, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Këshillit nr.183 datë 30.07.2020.
3. Kohëzgjatja e mandatit të Drejtorit të BKH-së është përcaktuar në fjalinë e fundit të pikës 2, të nenit 33 të Ligjit nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, i ndryshuar, dispozitë e cila parashikon se *“Drejtori emërohet për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë”*.
4. Për përlllogaritjen e saktë të këtij afati, vërejmë se vetë Ligji nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, i ndryshuar, nuk ka parashikime ligjore. Gjithashtu edhe Ligji nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, nuk ka parashikime ligjore për mënyrën e përlllogaritjes së afateve, por në nenin 189, pika 3 të tij, parashikon se *“Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast apo situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”*.
5. Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 2, pika 1, gërma “a”, parashikon ndërsa *“1. Ky Kod zbatohet kur organi publik, në ushtrimin e funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative: a) vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave, si dhe çdo rast tjetër, kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ”*, neni 56, pika 1 e po këtij Kodi, parashikon se *“Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike”*.
6. Në këto kushte, kur Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është organ publik, në kuptimin e parashikimeve të mësipërme, si edhe kur ligji i posaçëm, nuk ka parashikime të ndryshme në lidhje me përlllogaritjen e afateve ligjore, rezulton qartë se legjislacioni në fuqi, e detyron Këshillin që t’i referohet Kodit të Procedurave Administrative, ku ky i fundit, në nenin 56, pika 3 të tij parashikon se *“Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji”*.
7. Bazuar në sa më sipër, duke shqyrtuar vendimmarrjen e shumicës së Këshillit, vlerësojmë se ky qëndrim nuk është i drejtë për shkak se nuk është në përputhje me parashikimet e qarta të legjislacionit në fuqi. Në thelb, Këshilli ka vendosur që lirimi nga detyra i Drejtorit të

 BKH-së të ndodhë me kalimin e datës 31.08.2025, duke konsideruar këtë datë si përfundim të mandatit. Mirëpo, një vlerësim i tillë nuk është në përputhje me rregullat e llogaritjes së afateve, të cilat, sipas ligjit, janë të detyrueshme për çdo autoritet publik.

8. Ligji nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, i ndryshuar, në nenin 35 përcakton se, Drejtori i BKH-së lirohet nga detyra kur i përfundon mandati pesëvjeçar. Ky afat është i përcaktuar qartë edhe në vendimin e Këshillit nr. 183, datë 30.07.2020, ku thuhet se, mandati fillon më 1 shtator 2020 dhe ka kohëzgjatje 5 vjet. Për rrjedhojë, zgjidhja e çështjes së datës së saktë të mbarimit të mandatit nuk është çështje diskrecioni e Këshillit, por çështje e interpretimit të rregullave të detyrueshme të llogaritjes së afateve.
9. Në këtë drejtim, bazuar në parashikimin e nenit 56, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative, cituar më sipër, ngjarja juridike, nga e cila ka filluar të ecë mandati i Drejtorit në detyrë, është data 1 shtator 2020. Duke iu referuar kësaj dispozite, rezulton qartazi se afati 5-vjeçar nuk përfundon në datën 31 gusht 2025, duke qenë se kjo datë, në mënyrë të dukshme, nuk mban të njëjtin numër me datën e fillimit të mandatit.
10. Një interpretim i tillë i kufizues i kohëzgjatjes së mandatit është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, duke i hequr drejtuesit aktual, një ditë të plotë nga ushtrimi i detyrës, pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë arsye të justifikuar nga rrethana objektive. Për këto arsye, vlerësojmë se shumica, ka tejkaluar kufijtë e kompetencës së tij dhe ka zëvendësuar normën ligjore me gjykimin e anëtarëve të tij.
11. Nga sa më sipër, rezulton që ishte e domosdoshme të përcaktohej me saktësi, bazuar në parashikimet ligjore, se cila është dita në të cilën përfundon mandati pesëvjeçar i përcaktuar në nenin 35 të Ligjit nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, i ndryshuar, si dhe në vendimin e Këshillit nr. 183, datë 30.07.2020.
12. Vendimi i emërimit të Këshillit, në pikën 2 të dispozitivit të tij, përcakton shprehimisht se mandati i drejtueses fillon më datë 1 shtator 2020 dhe zgjat 5 (pesë) vjet. Ngjarja juridike që i dha jetë mandatit është fillimi i detyrës më datë 1 shtator 2020 dhe sipas nenit 56, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati i përcaktuar në vite mbaron me kalimin e asaj dite të atij viti që mban të njëjtin numër me ditën kur afati filloi të ecë. Në rastin konkret, kjo ditë rezulton që të jetë data 1 shtatori e vitit 2025.
13. Vlerësojmë se mandati është një e drejtë e fituar në momentin e fillimit të detyrës dhe gëzohet i plotë deri në ditën e fundit të afatit të përcaktuar. Vetëm në këtë mënyrë garantohej se drejtuesi ka ushtruar mandatin e tij të plotë, në respekt të plotë të ligjit dhe të parimit të shtetit të së drejtës.
14. Duke iu referuar nenit 56, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative, vlerësojmë se ky parashikim ligjor përbën një formulë të qartë dhe të qëndrueshme për llogaritjen e afateve të përcaktuara në vite, duke eliminuar çdo paqartësi që mund të lindë nga natyra e kalendarit “gregorian”. Ky i fundit, që zbatohet edhe në Shqipëri, nuk përbëhet nga vite me një numër



të pandryshueshëm ditësh, por alternon mes viteve të zakonshme me 365 ditë dhe viteve të brishtë me 366 ditë. Për pasojë, një afat i përcaktuar “në vite” nuk mund të kuptohet si një numër i thjeshtë ditësh, por duhet të lidhet domosdoshmërisht me datën kalendarike që përkon me ditën e fillimit të afatit, në vitin e fundit të tij.

15. Ligjvënësi, duke pasur parasysh këtë veçori të kalendarit vjetor ka përcaktuar shprehimisht se “*afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati*”. Kjo normë nuk lejon interpretime të tjera dhe synon pikërisht të shmangë konfuzionin që mund të lindte po të bëhej llogaritja thjesht mbi ditët e viteve, duke qenë se disa vite kanë 365 ditë dhe disa 366 ditë. Në këtë mënyrë, vendoset një standard i saktë dhe i parashikueshëm, ku çdo afat i shprehur në vite përfundon gjithmonë në datën që ka të njëjtin numër dhe të njëjtin muaj me datën e fillimit të afatit.
16. Duhet theksuar, se gjatë mandatit pesëvjeçar të drejtuesit aktual të BKH-së, janë përfshirë vite të zakonshme dhe vite të brishtë, ku përkatësisht vitet 2020 dhe 2024 kanë pasur 366 ditë, ndërsa vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2025 kanë 365 ditë. Ky fakt dëshmon edhe njëherë rëndësinë e rregullit të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, që numërimi i thjeshtë i ditëve nuk do të siguronte një përputhje të saktë me kohëzgjatjen e parashikuar në vite, pasi do të sillte rezultate të ndryshme sipas vitit të llogaritur. Për këtë arsye, vetëm aplikimi i formulës ligjore, që afati mbaron në ditën e atij muaji dhe atij viti që përkon me datën e fillimit të afatit, garantonte respektimin e saktësisë juridike.
17. Në arritjen e këtij konkluzioni, vlerësojmë se është me rëndësi të theksohet edhe praktika e ndjekur nga Gjykata Kushtetuese lidhur me përfundimin e mandateve të gjyqtarëve të saj. Vendimmarrjet e këtij organi kanë qenë të qarta dhe të qëndrueshme, ku rezulton se mandati përfundon në të njëjtën ditë kalendarike me atë në të cilën ka filluar, duke zbatuar parimin e që ka përcaktuar neni 56, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative.
18. Gjykata Kushtetuese ka qenë konsekuente që në vendimet e saj më të hershme, ku me vendimin nr. 2, datë 12.01.2007, ka shpallur mbarimin e mandatit të gjyqtarës V.M, duke u përcaktuar se mandati i saj përfundonte më 24.12.2006, pasi betimi ishte bërë më 24.12.1994. Në të njëjtën ditë, me vendimin nr. 3, datë 12.1.2007, shpalli mbarimin e mandatit të gjyqtarit K.P., duke u ndjekur saktësisht e njëjta llogjikë dhe me vendimin nr. 4, datë 12.1.2007, mbarimi i mandatit të gjyqtarit A.K., u përcaktua e njëjtë me datën e betimit.
19. Gjithashtu, më tej, në vendimin nr. 10, datë 02.04.2010, Gjykata Kushtetuese deklaroi se mandati i gjyqtarit K.P., i cili kishte bërë betimin më 01.04.1998, përfundonte saktësisht më 01.04.2010. Po ashtu, në vendimin nr. 19, datë 28.04.2010, u deklarua mbarimi i mandatit të gjyqtarit S.S., i cili kishte bërë betimin më 27.04.1998, duke e përfunduar mandatin më 27.04.2010. Në të njëjtën datë, me vendimin nr. 20, Gjykata Kushtetuese shpalli mbarimin e mandatit të gjyqtarit F.A., i cili gjithashtu kishte bërë betimin më 27.04.1998, duke e përfunduar mandatin më datën 27.04.2010.

SEKRET

20. E njëjta logjikë është ndjekur edhe në vendimet nr. 24, nr. 25 dhe nr. 26 të datës 24.05.2010, përkatësisht për gjyqtarët P.P., Xh. Z., dhe A. Th., të cilët kishin bërë betimin më 21.05.2001, duke iu shpallur mbarimi i mandatit në të njëjtën ditë kalendarike, 21.05.2010.
21. Nga të gjitha këto raste, rezulton e qartë se Gjykata Kushtetuese ka vendosur në mënyrë të njëtrajtshme, se mandati i gjyqtarëve të saj përfundon në të njëjtën ditë të kalendarit me atë në të cilën është bërë betimi dhe ka filluar ushtrimi i detyrës. Ky standard është një traditë juridike tashmë e konsoliduar, që garanton qartësi, siguri dhe parashikueshmëri juridike.
22. Duke iu referuar edhe vendimit më të fundit të Gjykatës Kushtetuese nr. 84, datë 23.12.2024, lidhur me mbarimin e mandatit të gjyqtarës H.Z., rezulton se ky rast e forcon edhe më tej parimin se mandatet kushtetuese apo ligjore përfundojnë gjithmonë në të njëjtën ditë të kalendarit me atë në të cilën kanë filluar. Është e rëndësishme të nënvizohet se Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e saj ka përcaktuar qartë se mandati i gjyqtarës H.Z. përfundon më 10 mars 2025. Siç vërehet nga vendimi, mandati i gjyqtarës V.T. që kishte filluar me datë 10 mars 2008, kishte përfunduar më 10 mars 2017 (vendimi nr.19, datë 10.3.2017 i Gjykatës Kushtetuese) dhe për pasojë, Gjykata ka shpallur se mandati i pasardhëses së saj, gjyqtarës H.Z., përfundon me datë 10 mars 2025.
23. Nga sa më sipër, në rastin konkret, bazuar në faktin se mandati i Drejtorit të BKH-së ka filluar më datë 1 shtator 2020, si edhe duke u bazuar në rregullin e vendosur prej nenit 56, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, në lidhje me përllogaritjen e afateve të përcaktuara në vite, rezulton se mandati pesëvjeçar i drejtueses aktuale përfundon me përfundimin e datës shtator 2025.

ZV/KRYETAR

Erind Gërmenji

(kundër)

ANËTAR
Sokol Stojani
(kundër)

ANËTAR
Olger Eminaj
(kundër)

ANËTAR
Erind Merkuri
(kundër)